



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 686, datë 14.11.2023

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT ASTRIT KALAJA, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Astrit Kalaja, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit Astrit Kalaja, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARIS
Ë PROFESIONALE

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT
DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER
VLERËSIMI**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

**1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN
E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE**

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu, në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkethehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” –

“Gjykata e njej ligjin”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, të cilët do të përcaktojnë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë, edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e çështjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin Astrit Kalaja.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për rëndësinë e natyrës së mosmarrëveshjes lidhur me zgjidhjen e çështjes (shih dokumentin nr.2 dhe dosjet nr.4 e 5). Identifikon kriteret kur shuhen titujt ekzekutive dhe i përdor ato për zgjidhjen e çështjes (shih dokumentin nr.2). Në çështjet penale, i kushton rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale (shih dokumentin nr.1 e 3 dhe dosjen nr.1 e 2), si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal”.

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke i referuar ato në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit. Duke u nisur nga mënyra se si janë pasqyruar rrethanat e çështjes, pothuajse në të gjitha vendimet e nënshtruara kësaj analize, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, gjykim penal themeli, apo kërkesë penale*), faktet parashtrihen në pjesën e parë të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit.

Pavarësisht se nuk rezulton si një nënpjesë e titulluar “Rrethanat e faktit”¹, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes në përputhje dhe në mënyrë të integruar me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht. Në disa raste, rrethanat e faktit përveç referimit sikurse kanë rezultuar të provuara gjatë gjykimit në shkallë të parë, merren sërish në analizë gjatë gjykimit në apel, në mënyrë të pavarur, në rastet kur shkaqet e ankimit kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe referojnë edhe në mënyrën e marrjes së provave apo provueshmërinë e

¹ Me përjashtim të vendimit nr. 260, datë 13.06.2016, në të cilin rrethanat e faktit të çështjes përshkruhen në nëndarjen e titulluar “Rrethanat e faktit” dhe të Vendimit nr. 167, datë 17.04.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër, në të cilin rrethanat e faktit pasqyrohen në nëndarjen të titulluar “Rrethanat e faktit që rezultojnë nga analiza e provave”.

fakteve të çështjes² apo në rastet kur gjykata e apelit ka vlerësuar ndryshe faktin³. Veçanërisht në këto të fundit, gjyqtari bën analizë të detajuar të të gjitha provave të marra në gjykim, duke u ndaluar tek fuqia provuese e tyre, në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në çështjet civile.

Gjyqtari i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në ankim apo qëndrimet e tyre gjatë gjykimit në apel por, duke integruar provat e administruara gjatë gjykimit dhe vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë mbi to, në rastet kur vendimi i ankimuar gjendet i drejtë, apo vlerësimi të gjykatës së apelit, kur kjo e fundit ka vlerësuar ndryshe elementë të fakteve të çështjes. Kjo vëmendje rezulton p.sh në vendimin penal me nr. 346, datë 15.09.2014, në të cilin gjyqtari i bën një vlerësim tërësor provave të marra në gjykim dhe posaçërisht fuqisë provuese të tyre në raport me faktin penal dhe përgjegjësinë penale të të pandehurve, për të konkluduar në mënyrë të ndryshme nga gjykata e shkallës së parë pikërisht lidhur me provueshmërinë e këtyre dy elementëve. Po ashtu në vendimin penal nr. 260, datë 13.06.2016, në të cilin gjyqtari rimerr në analizë tërësinë e provave të administruara në gjykim dhe, pavarësisht se konkludon për lënien në fuqi të vendimit të ankimuar, i analizon ato në tërësinë e tyre në përgjigje të shkaqeve të ankimit në drejtim të provueshmërisë dhe cilësimit juridik të faktit penal objekt akuze. Në vendimin civil nr. 1286, datë 16.10.2014 gjyqtari analizon faktet e provuara në gjykim, në raport me fuqinë provuese të provave shkresore, për të konkluduar ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, lidhur me këto elementë dhe zgjidhjen e çështjes në tërësi. Gjithashtu, në vendimin civil nr. 112, datë 07.03.2016, gjyqtari pavarësisht se konkludon në lënien në fuqi të vendimit të ankimuar, rimerr në analizë tërësinë e provave të administruara në gjykim, duke i dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim nga paditësja.

Në tërësi në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes për nxjerrjen e fakteve, analizën dhe cilësimin juridik të tyre, pa u lidhur me atë çfarë kanë prezantuar palët, duke i dhënë vendimeve gjyqësore qartësi në drejtim të pasqyrimin të fakteve të provuara, duke orientuar më pas analizën e shkaqeve të ankimit vetëm në raport me faktet e vlerësuara si të provuara në gjykim.

-Identifikimi i natyrës së çështjes:

Nga përshkrimi dhe analiza e fakteve të çështjes dhe nxjerrja e fakteve juridike të provuara në gjykim, gjyqtari përcakton natyrën e mosmarrëveshjes apo çështjes objekt shqyrtimi. Përcaktimit në mënyrë të qartë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur, jo vetëm sepse ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të gjykatës dhe që përbën edhe një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë por, duke e konceptuar atë edhe si një element thelbësor për të orientuar analizën ligjore të gjykatës lidhur me zgjidhjen e çështjes. Në këtë kontekst, nga vlerësimi në tërësi i vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, vihet re që, edhe pse jo e shprehur, gjyqtari e përcakton natyrën e

² Vendimi nr. 260, datë 13.06.2016, i Gjykatës së Apelit Shkodër, Vendimi nr. 112, datë 07.03.2016, i Gjykatës së Apelit Shkodër, Vendimi nr. 167, datë 17.04.2015, i Gjykatës së Apelit Shkodër.

³ Vendimi nr.346, datë 15.09.2014, i Gjykatës së Apelit Shkodër, Vendim nr. 1286, datë 16.10.2014, i Gjykatës së Apelit Shkodër (vendim i administruar për shkak të ankesave).

çështjes objekt shqyrtimi, nëse natyra juridike e çështjes është civile, penale themeli apo kërkesë penale.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes por, gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori *(i)* vendime civile dhe *(ii)* vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të aplikueshëm për zgjidhjen e çështjes, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (marrëdhënie pune, pavlefshmëri kontrate, pavërtetësi dokumenti, shlyerje detyrimi, konstatim absolutisht i pavlefshëm vendimi të KKP, shuarje titulli ekzekutiv, përmbushje detyrimi kontraktual etj.), gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Punës, por edhe dispozita të ligjeve të posaçëm kur ato vijnë në shërbim të analizës lidhur me zgjidhjen e çështjes. Konkretisht në disa prej vendimeve civile burim vlerësimi evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave materiale civile lidhur me:

- a) *Pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, pasojat e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe shkaqet e zgjidhjes së kontratës,* duke cituar dhe referuar për këtë qëllim nenet 79/1, 92, të Kodit Civil⁴;
- b) *Zgjidhjen e kontratës së punës,* duke cituar nenin 144 të Kodit të Punës në lidhje me procedurën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, nenin 143 të K. Punës në lidhje me respektimin e afatit të njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës, nenin 153 të K. Punës në kuadër të zgjidhjes së çështjes nëse në rastin objekt gjykimi jemi para një zgjidhje të bërë nga ana e punëdhënësit në mënyrë të menjëhershme dhe të justifikuar, si dhe pasoja ligjore e kësaj zgjidhje e parashikuar në nenin 155 dhe 145 të K. Punës⁵.

Në vendimet gjyqësore rezulton citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile, lidhur me vlerësimin e shkaqeve të ankimit që konsistojnë në elementë të procedurës, si dhe në rastet kur mosmarrëveshja konkrete lidhet me dispozita procedurale dhe konkretisht:

- a) *Njohja e vërtetësisë dhe pavërtetësisë së një dokumenti* (neni 32/c të K.Pr.Civile)⁶;
- b) *Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv* (neni 609 i K.Pr.C) në raport me kërkimin objekt gjykimi për deklarimin e titullit ekzekutiv të shuar për shkak të kalimit të afateve maksimale të kërkimit të përmbushjes së detyrimit⁷;
- c) *Kopja e shkresës dhe origjinali i saj* (neni 251 i K.Pr.C) në lidhje me saktësinë dhe fuqinë e shkresës kur vërtetohet nga personi kompetent⁸;

⁴Vendimi civil nr. 1286, datë 16.10.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵Vendimi nr. 700, datë 05.12.2013, Vendim nr. 997, datë 15.05.2014, Vendimi nr. 293, datë 13.05.2015, i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁶ Vendimi nr. 112, datë 07.03.2016 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁷ Vendimi nr. 1228, datë 25.09.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁸ Vendimi nr. 1286, datë 16.10.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër

(ii) Në vendimet penale të themelit, gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodin Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, dhe dispozita të pjesës së përgjithshme, kryesisht lidhur me moshën për përgjegjësi penale, përcaktimin e dënimit, rrethanave renduese dhe alternativat e dënimit me burgim. Konkretisht, gjyqtari identifikon:

- a) nenin 137 të Kodit Penal në lidhje me cilësimin juridik të faktit në raport me elementët e veprës penale të « Vjedhjes të energjisë elektrike ose impulseve telefonike »⁹;
- b) nenin 183/1 të Kodit Penal në lidhje me cilësimin juridik të faktit në raport me elementët e veprës penale të « Fallsifikimit të monedhave »¹⁰;
- c) nenin 78/2 të Kodit Penal në lidhje me cilësimin juridik të faktit në raport me elementët e veprës penale të « Vrasjes me paramendim për hakmarrje » dhe nenin 278/2 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale të « Mbajtjes pa leje të armëve luftarake »¹¹;
- d) nenin 79 dh-25 dhe 79ë-25 të Kodit Penal në lidhje me cilësimin juridik të faktit në raport me elementët e veprës penale të « Vrasjes të kryer në rrethana të tjera cilësuese », nenin 278/2 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale të « Mbajtjes pa leje të armëve luftarake ».¹²
- e) nenin 47 lidhur me individualizimin e dënimit¹³ dhe nenin 59 të Kodit Penal lidhur kushtet dhe kriteret e aplikimit të alternativës së dënimit me burgim¹⁴;

Në vendimet penale burim vlerësimi rezulton citimi dhe analiza e dispozitave procedurale penale, lidhur me vlerësimin e shkaqeve të ankimit që konsistojnë në elementë të procedurës, si dhe në rastet kur çështja objekt shqyrtimi është e natyrës procedurale dhe konkretisht:

- a) nenet 149, 150 dhe 152 të K.Pr.P lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së marrjes dhe vlerësimit të provave në drejtim të mbështetjes së bindjes së brendshme të gjykatës¹⁵;
- b) nenet 228 dhe 229 të K.Pr.P lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal¹⁶;
- c) neni 428 të K.Pr.P lidhur me rastet kur Gjykata e Apelit vendos për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me një tjetër trup gjykues, neni 152 të K.Pr.P në lidhje me çmuarjen e provave dhe neni 346 i K.Pr.P, në lidhje me pretendimet për pavlefshmëri të procesverbalit gjyqësor si akt procedural penal¹⁷;

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

⁹ Vendimi nr. 303, datë 29.06.2016 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁰ Vendimi nr. 227, datë 08.05.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹¹ Vendimi nr. 346, datë 15.09.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹² Vendimi nr. 167, datë 17.04.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹³ Vendimi nr. 167, datë 17.04.2015, Vendimi nr. 346, datë 15.09.2014, Vendimi nr. 227, datë 08.05.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹⁴ Vendimi nr. 135, datë 26.03.2015, Vendimi nr. 227, datë 08.05.2014, Vendimi nr. 303, datë 29.06.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁵ Vendimi nr. 346, datë 15.09.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁶ Vendimi nr. 208, datë 10.08.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁷ Vendimi nr. 167, datë 17.04.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, analizën e tyre, si dhe në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, e aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Pavarësisht faktit që interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore, në mënyrë të veçantë gjykatat më të larta (*Apelit apo Gjykata e Lartë*) duhet të luajnë një rol të rëndësishëm për t’i udhëzuar gjykatat më të ulëta në interpretimin, sqarimin dhe zbatimin e së drejtës materiale dhe procedurale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit Astrit Kalaja ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit....Në vendimet gjyqësore nuk i përdor rregullisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit ai përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (shih dosjet nr.3 e 4) dhe aktet të tjera ligjore (shih dosjen nr4). Në tre dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, vetëm në një rast, ka disponuar kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë (shih dosjen nr.5). Nga ana tjetër, prej 5 dosjeve të vëzhguara, palët ndërgjyqëse kanë paraqitur ankim kundër vendimit të dhënë prej tij vetëm në dy raste (shih dosjen nr.11 dhe dosjen nr.2)”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në 14 vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile ose penale apo procedurale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Por, interpretimi i ligjit të zbatueshëm, nuk rezulton të jetë bërë në të njëjtën masë dhe me të njëjtën vëmendje në të gjitha vendimet burim vlerësimi pasi, në disa prej tyre, referimi në dispozitat ligjore dhe për pasojë, interpretimi abstrakt i tyre, para aplikimit mbi faktin mungon, sepse shkaqet e ankimit i referohen faktit dhe mënyrës së vlerësimit të provës dhe jo çështjeve që lidhen me interpretimin dhe zbatimin e ligjit material¹⁸. Normat ligjore të zbatueshme, kryesisht ato materiale, citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të së cilit ato citohen apo referohen, me përjashtim të dy vendimeve në të cilat dispozitat ligjore referohen në një nënndarje të veçantë të titulluar “Ligji i zbatueshëm”¹⁹. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarit sipas qëllimit dhe funksionit të tyre, në mbështetje të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Interpretimi i normave juridike të ligjit material është bërë duke identifikuar qëllimin e normës, përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim dispozita konkrete. Konkretisht, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, sa i përket interpretimit të ligjit material, rezulton se gjyqtari:

- (i) Interpreton nenin 144 të K.Punës jo vetëm teorikisht, por edhe në përputhje me faktet dhe provat, në lidhje me faktin nëse në rastin objekt gjykimi është respektuar procedura e zgjidhjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit²⁰ ;
- (ii) Interpreton nenin 153 të K.Punës në lidhje me faktin nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet për të zgjidhur marrëdhënien e punës në mënyrë të menjëhershme në rastin konkret, duke arritur në konkluzionin se jemi para një kontrate me afat të pacaktuar dhe faktit se nga ana e palës së paditur nuk rezulton që të jetë respektuar afati i njoftimit të parashikuar në nenin 143 të K.Punës (*mosrespektim ky i bërë mbi vullnetin e vetë punëdhënësit, duke e konsideruar zgjidhjen e marrëdhënies së punës me paditësen për shkaqe të justifikuara*). Këtë interpretim gjyqtari e bën jo vetëm duke iu referuar interpretimit teorik të dispozitës, por në përputhje edhe me faktin dhe provat e administruara²¹ ;
- (iii) Interpreton ligjin e zbatueshëm (*nenin 609 të K.Pr.Civile*) në funksion të zgjidhjes së çështjes, jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar qëllimin e dispozitës por, duke e përputhur këtë interpretim me faktin dhe provat e administruara për të konkluduar në lidhje me pretendimet e paditësit për shuarjen e titullit ekzekutiv për shkak të kalimit të afateve maksimale të kërkimit të përmbushjes së detyrimit, për shkak se e drejta e kreditorit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit dhe të ekzekutimit të tij është parashkruar²² ;
- (iv) Interpreton nenin 131/b të Kodit Civil, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, jo vetëm në aspektin teorik të saj por, në përputhje dhe me faktin dhe provat objekt gjykimi, duke referuar në dy rrethana konkrete të cilat vërtetojnë ndërprerjen e afateve të parashkrimit²³ ;

¹⁸ Vendimi nr. 112, datë 07.03.2016, Vendimi nr.1023, datë 22.05.2014, Vendimi nr. 997, datë 15.05.2014, Vendimi nr. 1389, datë 20.11.2014, Vendimi nr. 135, datë 26.03.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹⁹ Vendimi nr. 293, datë 13.05.2015, Vendimi nr. 1286, datë 16.10.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁰ Vendimi nr. 700, datë 05.12.2013, i Gjykatës së Apelit Shkodër

²¹ Po aty

²² Vendimi nr. 1228, datë 25.09.2014, i Gjykatës së Apelit Shkodër

²³ Po aty

- (v) Interpreteton nenin 137 të Kodit Penal, në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, duke arritur në konkluzionin e konsumimit të veprës penale nga ana e të pandehurit²⁴ ;
- (vi) Interpreteton nenin 79/dh dhe 79/ë të Kodit Penal, në raport me faktet e provuara në gjykim, duke analizuar elementët e figurës së veprës penale, e duke u ndalur posaçërisht në analizën e kësaj dispozite në raport me dispozitat e tjera të veçanta që përmban seksioni i kreut të parë dhe i kreut të dytë të veprave penale kundër personi, në lidhje me ardhjen e pasojës, e cila në rastin konkret kërkon dashjen direkte të subjektit që kryen veprën penale²⁵ ;
- (vii) Interpreteton nenin 290 të Kodit Penal, duke analizuar elementët e figurës së veprës penale, në raport me faktet e provuara në gjykim, duke e cilësuar një dispozitë blankete dhe duke referuar në dispozita të tjera ligjore të Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore të dalë në bazë dhe për zbatim të tij²⁶ ;
- (viii) Interpreteton nenin 47 të Kodit Penal në raport me kriteret që janë konsideruar nga gjykata e shkallës së parë në individualizimin e dënimit për të pandehurin²⁷ ;
- (ix) Interpreteton nenin 59 të Kodit Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe vënien e të pandehurit në provë, duke e ballafaquar interpretimin e tij me rrethanat konkrete dhe rrezikshmërinë e të pandehurit dhe veprës penale për të cilën është gjetur fajtor²⁸.

- Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale:

Gjyqtari, referuar pretendimeve të ngritura nga ana e palëve në ankim, interpreton në përputhje me rrethanat e faktit, dispozitat procedurale që kanë lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë përfundimtare. Konkretisht:

- (i) Interpreteton nenin 152/2 të K.Pr.Penale, në funksion të pretendimeve të të pandehurit të ngritura në ankim, në lidhje me mosprovimin e fajësisë, duke analizuar interesin e të pandehurit për kryerjen e veprës penale si një indicje e cila vlerësohet në raport me provat e tjera, duke i dhënë një interpretim të veçantë indicies si një element provueshmërie për ekzistencën e një fakti, duke cituar gjithashtu, kushtet që duhet të ekzistojnë që indicia të shërbejë si element provueshmërie për ekzistencën e faktit penal²⁹ ;
- (ii) Interpreteton nenin 428 të K.Pr.Penale, lidhur me pretendimet e të pandehurve të ngritura në ankim, në lidhje me prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po asaj gjykate me trup tjetër gjykues. Gjykata në interpretim të kësaj dispozite, arrin në konkluzionin se shkaqet e ngritura në ankim lidhen me një interpretim të ndryshëm që i bëhen provave dhe përfundimeve të analizës së tyre dhe nuk lidhen me një proces të parregullt që sjell si pasojë prishjen e vendimit³⁰ ;
- (iii) Interpreteton nenet 149, 150 dhe 152, të K.Pr.Penale, në funksion të arsyetimit se gjykata e faktit duhet të kishte pasur parasysh kërkesat që përcakton Kodi i Proedurës Penale për marrjen e provave, duke vlerësuar se ekzistenca e faktit nxirret jo nga një provë por, nga analiza e disa provave të cilat pasqyrojnë faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë, caktimin e masave të sigurimit, dënimin³¹ ;
- (iv) Interpreteton në raport me faktet e çështjes, nenet 228, 229 të K.Pr.P lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së arrestimit ne flagrancë, kushteve dhe kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masave të sigurimit personal, si dhe ndalimin e gjykatës për të vendosur një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga organi i akuzës³² ;
- (v) Interpreteton nenin 377 të K.Pr.Penale, lidhur me pretendimin e të pandehurit vendimmarrjen e gjykatës të shkallës së parë, e cila duhej të vendoste kthimin e akteve organit të akuzës, duke e konsideruar të

²⁴ Vendimi nr. 303, datë 29.06.2016, i Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁵ Vendimi nr. 167, datë 17.04.2015, i Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁶ Vendimi nr. 260, datë 13.06.2016, i Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁷ Vendimi nr. 167, datë 17.04.2015, Vendimi nr. 346, datë 15.09.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁸ Vendimi nr. 227, datë 08.05.2014, Vendim nr. 303, datë 29.06.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁹ Vendimi nr. 303, datë 29.06.2016 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³⁰ Vendimi nr. 167, datë 17.04.2015, Vendimi nr. 260, datë 13.06.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër

³¹ Vendimi nr. 346, datë 15.09.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³² Vendimi nr. 208, datë 10.08.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër

pabazuar, duke mos konstatuar asnjë kusht të përcaktuar në këtë në lidhje me kthimin e akteve të prokurorit³³.

- **Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.**

Në disa nga vendimet e analizuara rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ*, në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

Në disa prej vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- a) Respektimin e afatit të njoftimit dhe respektimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës (*Vendimi Unifikues Nr. 19, datë 15.11.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe Vendimi nr. 33, datë 12.09.2007 i Gjykatës Kushtetuese*)³⁴;
- b) Legjitimitimin e palës paditëse për ngritjen e padisë për të kundërshtuar vendimin e KKKP (*çështja Maria Atanasiu dhe të tjerë kundër Rumanisë, GJEDNJ dhe Vendimi Unifikues nr. 25/2003, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*)³⁵;
- c) Rivendosjen e të drejtës së mohuar të pronësisë, nëpërmjet shprehjes së vullnetit të organit publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik ndaj një subjekti individualisht të përcaktuar të së drejtës, duke shqyrtuar bazueshmërinë e pretendimeve të palës paditëse rreth ligjshmërisë së vendimit të KKKP objekt kundërshtimi (*Vendimi Unifikues nr. 24, datë 13.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendimi nr. 27, datë 27.07.2009, i Gjykatës Kushtetuese*)³⁶;
- d) Ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale (Vendimi nr. 51, datë 30.07.1999 i Gjykatës Kushtetuese)³⁷;
- e) Procedimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, si kompetencë ekskluzive e gjyqtarit, në përputhje me veçoritë e gjykimit (*Vendimi nr. 4, datë 10.02.2012, i Gjykatës Kushtetuese*)³⁸.

- **Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës**

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes gjyqtari përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur, siç janë parimet e procesit të rregullt ligjor apo ai i aksesit të palëve, identifikohet dhe reflektohet përmes zbatimit të parimit të kontradiktoritetit e barazisë së palëve, si një nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor etj. Gjithashtu konstatohet zbatimi i parimit të proporcionalitetit gjatë arsytimit dhe konkluzionit të arritur në lidhje me caktimin e masës së sigurimit ndaj personit nën hetim³⁹. Gjithashtu, rezulton se në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi⁴⁰, arsytimi është përqendruar kryesisht në analizën dhe vlerësimin e fakteve të çështjes, proces që duket të ketë

³³ *Vendimi nr. 260, datë 13.06.2016 i Gjykatës së Apelit Shkodër*

³⁴ *Vendimi nr. 997, datë 15.05.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër*

³⁵ *Vendimi nr. 1286, datë 16.10.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër*

³⁶ *Po aty*

³⁷ *Vendimi nr. 260, datë 13.06.2016 i Gjykatës së Apelit Shkodër*

³⁸ *Po aty*

³⁹ *Vendimi nr. 208, datë 10.08.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër*

⁴⁰ *Vendimi nr. 112, datë 07.03.2016, Vendimi nr.1023, datë 22.05.2014, Vendimi nr. 997, datë 15.05.2014, Vendimi nr. 1389, datë 20.11.2014, Vendimi nr. 135, datë 26.03.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër.*

qenë i kondicionuar nga shkaqet e ngritura në ankim, të cilat i referohen provueshmërisë së fakteve dhe jo analizës ligjore të tyre.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka shfaqur aftësi shumë të mira të interpretimit të ligjit kryesisht atij procedural penal dhe ligjit material penal dhe civil, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësorë unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit Astrit Kalaja ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi i respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, por nuk i përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të shkruara më një gjuhë të thjeshtë, të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm jo vetëm për njohësit e ligjit, por edhe për një lexues të arsyeshëm. Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë, duke reflektuar vijën logjike të mendimit. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, fjalëve fyese apo denigruese. Nuk rezultojnë raste të përdorimit të gjuhës teknike, diktuar nga natyra e çështjeve si dhe nuk rezultojnë raste të referimit të parimeve apo instituteve të së drejtës në gjuhën latine.

Gjyqtari përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, të cilat janë të qarta dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Paragrafët e arsytimit të vendimit janë të lidhur me njëri tjetrin, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër dhe duke e bërë vendimin të organizuar në rrjedhë logjike. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse në pjesën hyrëse të vendimit gjyqësor, paraqiten në mënyrë të përmbledhur duke u bazuar mbi shkaqet e ankimit.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Zgjedhja, përdorimi dhe organizimi i fjalëve dhe fjalive siguron një balancim midis të shprehurit thjesht dhe konciz në raport me vijueshmërinë e mendimit të shprehur.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrë e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*) CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Struktura e vendimeve të tij është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Ajo përmban të gjithë elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural, civil e penal. Subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve dhe organizmi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm... Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara është konstatuar se nuk disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore dhe nuk tregohet e drejta e ankimit për palët*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari Astrit Kalaja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, duke e pozicionuar ligjin në përmbajtje të argumenteve të tij, në secilën pjesë të veçantë të arsytimit, për të vijuar me paraqitjen e konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Gjyqtari ndjek një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, pavarësisht se nuk i identifikon ato me tituj apo ndarje të dukshme në aspektin vizual, duke iu përshtatur edhe gjykimit në apel, për shkak të së cilit i duhet të citojë edhe vendimmarrjen objekt ankimi, pjesë të arsytimit të gjykatës së shkallës së parë në disa raste, si dhe shkaqet e ankimit të palëve. Ndërsa në disa raste, pjesët përbërëse të vendimeve identifikohen me tituj dhe ndarje në aspektin vizual.⁴¹ Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet/shkaqet e ankimit të subjekteve në gjykimin në Apel, të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur në pjesën hyrëse dhe po ashtu pasqyrohen në disa vendime më komplekse, në mënyrë të zgjeruar, së bashku me argumentet e palëve.

Pjesa përshkuese – arsyetuese është e organizuar si një e tërë në aspektin vizual por në aspektin e përmbajtjes, është e strukturuar duke marrë në analizë : (i) rrethanat dhe faktet e çështjes siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi; (ii) rrethanat procedurale në gjykimin në apel dhe vlerësimi i gjykatës së apelit mbi shkaqet e ankimit, paraqitur në formën e një konkluzioni, për të vijuar më pas me referimin dhe analizën e ligjit të zbatueshëm, si dhe elementët e tij në

⁴¹ *Vendimi nr. 167, datë 17.04.2015, Vendimi nr. 303, datë 29.06.2016, Vendimi nr. 1286, datë 16.10.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër*

përputhje me faktet konkrete (iii) konkluzionin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me zgjidhjen e çështjes, duke e paraqitur atë në mënyrë të përmbledhur dhe në disa raste, duke referuar ose cituar pjesë nga arsyetimi i vendimit të ankimuar (iv) konkluzionin e gjykatës së apelit lidhur me çështjen, duke konkluduar arsyetimin e vendimit nëse vendimi i gjykatës së shkallës së parë objekt ankimi është i drejtë dhe i bazuar dhe duhet të lihet në fuqi apo nëse ka vend për ndryshimin e tij.

Ndërsa në rastet kur pjesa përshkruese – arsyetuese e vendimit është e organizuar me nënndarje, gjyqtari në çështjet penale rendit provat e nënshtruara shqyrtimit gjyqësor, analizon provat shkresore, pasqyron në mënyrë të përmbledhur deklaratimet e dëshmitarëve, pasqyron rrethanat e faktit të cilat kanë rezultuar nga analiza e provave, paraqet vlerësimin ligjor të gjykatës si dhe analizon pretendimet e palëve të ngritura në ankim⁴², Në çështjet civile, gjyqtari paraqet në nënndarje të veçantë rrethanat e çështjes, arsyetimin ligjor të gjykatës së shkallës së parë, ligjin e zbatueshëm dhe analizën ligjore të çështjes mbi bazën e provave të rezultuara gjatë shqyrtimit gjyqësor⁴³.

Në çështje me natyrë komplekse, pavarësisht konkluzionit mbi faktet e pranuar nga gjykata e shkallës së parë, gjyqtari rimerr në analizë secilin prej tyre, në raport me shkaqet e ankimit, duke i rivlerësuar dhe analizuar sërish faktet, në mbështetje të argumenteve të tij për bazueshmërinë ose jo të shkaqeve të ankimit objekt shqyrtimi nga gjykata e apelit.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Civile apo nenit 428 të K.Pr.Penale, si dhe data e shpalljes së vendimit. Nuk rezulton të jetë referuar e drejta e ankimit ndaj vendimit.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, vendimet civile elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe nenit 466 të K.Pr.Civile dhe vendimet penale elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale. Gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, duke zbatuar rregullat e shkrimit ligjor duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe i kushton rëndësi evidentimit të fakteve të çështjes, analizës së tyre, aplikimit të ligjit mbi to dhe paraqitjen e konkluzioneve të arritura mbi bazën e kësaj analize.

⁴² Vendimi nr. 167, datë 17.04.2015, i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁴³ Vendimi nr. 1286, datë 16.10.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme. Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila paraqitet e thjeshtë dhe e kushtueshme. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor... Ai jo gjithmonë i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat disa herë mungon arsyetimi (shih dosjet nr.2 dhe 3). Në 3 raste të tjera, ai ka proceduar duke nxjerrë vendime të ndërmjetme, duke treguar shkakun ligjore (shih dosjet nr.1, 4 dhe 5)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në shumicën e vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal objekt shqyrtimi, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale, si në rastet kur ai përbën shkak ankimi ashtu edhe në rastet kur analiza e fakteve dhe dispozitave me natyrë procedurale është thelbësore për zgjidhjen e çështjes.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal, duke integruar këto elementë në çdo rast me faktet e provuara në gjykim, të cilat edhe në rastet kur pranohen se janë vlerësuar

drejt nga gjykata e shkallës së parë, merren në analizë dhe vlerësohen nga gjyqtari gjatë gjykimit në apel, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve të tij për zgjidhjen e çështjes. Në pjesën me të madhe të vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarit për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore të së drejtës materiale ose procedurale, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes, përcaktimi në mënyrë të shprehur i thelbit të mosmarrëveshjes ose çështjes penale objekt shqyrtimi, duke orientuar më pas analizën e faktit dhe të ligjit në shërbim të arritjes së konkluzioneve mbi shkaqet e ankimit dhe zgjidhjen në tërësi të çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse duke i analizuar ato me vete në shumicën e vendimeve burim vlerësimi. Në disa vendime të cilat kanë të bëjnë me konflikte jo komplekse, analiza e shkaqeve të ankimit behët në tërësi në arsyetim, pa i veçuar ato nga njëra tjetra, por në çdo rast duke i dhënë përgjigje të argumentuar.

Në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi, përveç analizës së provave dhe nxjerrjes së faktit juridik konkret, gjyqtari i kushton rëndësi edhe analizës së instituteve të caktuara të së drejtës apo koncepteve të caktuara ligjore, kur kjo rezulton e nevojshme p.sh.: (i) konceptin e “Shkak i justifikuar” në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës⁴⁴; (ii) instituti i hakmarrjes, duke bërë dallimin midis hakmarrjes dhe gjakmarrjes si një formë specifike dhe e veçantë e hakmarrjes, duke i trajtuar si motive që ndikojnë në vlerësimin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe autorit⁴⁵.

Në arsyetimin e vendimeve, në analizën e ndërthurur të faktit dhe ligjit, në shërbim të mbështetjes së konkluzioneve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, gjyqtari i kushton rëndësi dhe evidentohen në mënyrë të shprehur lidhjen të shkak – pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore në çështjet penale, duke orientuar argumentimin logjik të tij në mbështetje të këtij raporti.

KONKLUZIONI

Në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësuar në tërësinë e tyre dhe në raport të drejtë me natyrën komplekse ose jo të çështjes, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi marrjes në analizë së çdo pretendimi të ngritur në ankim, duke i dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të palëve si për çështje të procedurës ashtu edhe për themelin e zgjidhjes së saj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

⁴⁴Vendimi nr. 700, datë 05.12.2013 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁵ Vendimi nr. 346, datë 15.09.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër

Niveli i vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtarin Astrit Kalaja, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga dita e marrjes së akteve me short gjer në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme. Kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 7 ditë (shih dosjen nr.3), ndërsa kohëzgjatja më e lartë ka qenë 11 muaj e 9 ditë (shih dosjen nr.2)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimit të administruar për shkak të ankesave dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimit të administruar për shkak të ankesave dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, nuk parashikohet afat ligjor për

gjykimin e tyre në Apel,⁴⁶ përveç një çështje me objekt “Vleftësim ndalimi, caktim mase sigurimi”, për të cilën në nenin 249, pika 5⁴⁷ të K.Pr.Penale parashikonte afatin 10 ditor të shqyrtimit.

Konkretisht:

- (i) Çështja penale me nr. 200 akti, datë regjistrimi 03.08.2015 me objekt “Vleftësim ndalimi dhe caktim mase sigurimi”, ndaj shtetasit J.Gj, përfunduar me vendimin nr. 208, datë 10.08.2015, është regjistruar në gjykatën në datë 03.08.2015 dhe ka përfunduar në datë 10.08.2015, për një afat kohor prej 7 ditësh, duke respektuar afatin ligjor 10 ditor sipas parashikimeve të nenit 249, pika 5 të K.Pr.Penale.

Për 10 çështjet e tjera të përzgjedhura me short, 3 vendimet e tjera të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim si dhe vendimit të administruar për shkak të ankesave, referuar legjislacionit procedural në fuqi në kohën e zhvillimit të gjykimeve, nuk rezulton të jenë parashikuar afate ligjore shqyrtimi.

KONKLUZIONI

Pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi dhe nga dokumentet e përdorura gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka të dhëna të tjera veç çështjes së mësipërme, që mund të vlerësohen në drejtim të këtij treguesi, prezumohet se gjyqtari i ka gjykuar të gjitha çështjet e tjera për të cilat parashikohet afat ligjor, brenda këtij të fundit. Pikëzimi i këtij treguesi do të bëhet duke iu referuar çështjes së përshkruar më sipër si dhe mungesës së të dhënave të tjera që mund të vlerësohen në këtë drejtim në lidhje me të gjitha çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi çka sjell si pasojë, prezumimin se gjyqtari i ka gjykuar të gjitha çështjet për të cilat parashikohet afat ligjor, brenda këtij të fundit, prandaj vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues, duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi mbështetur në burimet e vlerësimit nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor.*

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

⁴⁶ Afati ligjor 60 ditë i parashikuar për përfundimin e çështjeve në gjykimin në Apel në nenin 609 të K.Pr.Civile ka hyrë në fuqi në Korrik 2016, po kështu edhe afati 15 ditë i parashikuar në nenin 21 të ligjit 9669 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, është shtuar me ndryshimet e ligjit në vitin 2018, pra të dyja këto afate ligjore gjykimi nuk i përkasin periudhës objekt vlerësimi.

⁴⁷ Në nenin 249, pika 5 të K.Pr.Penle, sipas dispozitës në fuqi në kohën e zhvillimit të këtij procesi, parashikohej se: “5. Kërkesa shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve”.

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtarin Astrit Kalaja, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga dita e marrjes së akteve me short gjer në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme. Kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 7 ditë (shih dosjen nr.3), ndërsa kohëzgjatja më e lartë ka qenë 11 muaj e 9 ditë (shih dosjen nr.2). Në tre rastet e tjera gjykimet kanë zgjatur 9 muaj (shih dosjen nr.5); 9 muaj e 16 ditë (shih dosjen nr.1) dhe 9 muaj e 22 ditë (shih dosjen nr.4). Nga analiza e këtyre të dhënave, në raport me standardet kohore për çështjet penal dhe civile në shkallë të dytë sipas pikës 5 shkronja “g”; “h” dhe “j” të Aneksit të Sistemit të Vlerësimit, konstatohet se vetëm 1 çështje është përfunduar brenda afateve standard (shih dosjen nr.3), ndërsa katër çështjet e tjera janë përfunduar tej standardeve (shih dosjet nr.1, 2, 4 e 5). Megjithatë, në analizën e kësaj të dhëne, duhet evidentuar se sipas nenit 460/2 të K.Pr.Civile, seanca e parë gjyqësore në çështjet civile që shqyrtohen në Gjykatën e Apelit caktohen nga kryetari i Gjykatës. Nën këtë analizë, duhet evidentuar se në 3 nga të 5 rastet e vëzhguara të gjyqtarit Astrit Kalaja, gjykimet nga seanca e parë gjer në shpalljen e vendimit përfundimtar nuk kanë pasur vonesa. Në dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit është analizuar kohëzgjatja, sipastributeve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtari, por i referohet datës së regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Apelit. Nga analiza e kohëzgjatjes së gjykimeve në tre dokumentet, është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë 4 muaj e 9 ditë (shih dokumentin nr.1); 7 muaj e 15 ditë (shih dokumentin nr.3) dhe 2 vjet e 8 muaj e 19 ditë (shih dokumentin nr.2). Sipas analizës si më sipër, duhet evidentuar se në 2 nga 3 dokumentet e paraqitura nga gjyqtari Astrit Kalaja, gjykimet nuk kanë pasur vonesa, ndërsa vendimi i tretë i përket çështjes civile, seanca e parë e të cilës caktohej nga kryetari i gjykatës”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Për 10 nga çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjykimi, vendimit të administruar për shkak të ankesave dhe 3 nga vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD.⁴⁸

Referuar 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari, konstatohet se:

⁴⁸Në pikën 5 të Aneksit g dhe h të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e Apelit jo më tej se 2 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 6 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.” Gjykimet civile në Gjykatën e Apelit jo më tej se 6 muaj”.

- (i) Në çështjen penale nr. 429 (00248) regj, ndaj të pandehurve E.Gj. dhe N.Sh., akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 76, 278/4 dhe 302/1 të Kodit Penal, sipas të dhënave në pjesën hyrëse të këtij vendimi rezulton se data e regjistrimit është 06.05.2014 dhe data e përfundimit të çështjes 15.09.2014. Duke iu referuar datës së regjistrimit të çështjes,⁴⁹ kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 4 muaj e 9 ditë, ***brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj***, referuar vendimit 261/2 të KLD;
- (ii) Në çështjen civile nr. 122/698/1152 (00033) regj, me palë paditëse N.P., palë e paditur ATK, etj., me objekt “Deklarimin e titullit ekzekutiv të shuar...”, sipas të dhënave në pjesën hyrëse të këtij vendimi rezulton se data e regjistrimit është 06.01.2012 dhe data e përfundimit të çështjes 25.09.2014, pra për një kohëzgjatje prej 2 vjet, 8 muaj e 19 ditë, në tejkalim të standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD. Në mungesë të të dhënave mbi datën e vënies në lëvizje të çështjes dhe caktimit të seancës së parë gjyqësore nëpërmjet shpalljes së listave të gjyqimit nga kryetari i Gjykatës në referim të parashikimeve të nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile,⁵⁰ përlllogaritja e kohëzgjatjes së gjyqimit në këtë këndvështrim rezulton e pamundur dhe për pasojë, ky vendim nuk mund të shërbejë si burim vlerësimi për këtë tregues, pasi nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar kohëzgjatjen e gjyqimit dhe për pasojë, për të vlerësuar nëse ajo është përfunduar brenda apo jashtë afatit standard në fuqi.
- (iii) Në çështjen penale nr. 79/570 (00467) regj, ndaj të pandehurve A.P., S.P., B.P. dhe F.P., akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 79/dh në lidhje me nenin 25 të K.Penal, nenin 79/ë në lidhje me nenin 22 e 25 të K.Penal dhe nenin 278/2 të Kodit Penal, sipas të dhënave në pjesën hyrëse të këtij vendimi rezulton se data e regjistrimit është 02.09.2014 dhe data e përfundimit të çështjes 17.04.2015. Duke iu referuar datës së regjistrimit të çështjes, kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 7 muaj e 15 ditë, ***brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj***, referuar vendimit 261/2 të KLD.

Referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjyqimi, konstatohet se:

- (iv) Çështja penale me nr. 88/547 regj, datë regjistrimi 19.07.2013, e kategorisë penale themeli, ka përfunduar me vendimin nr. 227, datë 08.05.2014, për një kohëzgjatje prej 9 muaj e 19 ditë, jashtë afatit standard minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjen në datë 26.03.2014, duke caktuar seancën e parë gjyqësore në datë

⁴⁹Në mungesë të të dhënave të tjera në çështjet e përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat administrohen në dosje vetëm vendimet përfundimtare.

⁵⁰Në nenin 460 të K.Pr.Civile, para ndryshimeve të këtij neni me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, parashikohet se: “Gjykata e apelit e shqyrton çështjen në mënyrë kolegjiale. Ajo gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. ***Kryetari i gjykatës së apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjyqimit.*** Sekretaria e gjykatës së apelit i njofton palët rregullisht (nenet 128-133) të paktën 10 ditë më parë, ditën e shqyrtimit të çështjes në apel, si dhe shpall listën përkatëse të çështjeve”.

24.04.2014, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 1 muaj e 12 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muajsh*** parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.

- (v) Çështja penale me nr. 227/674 regj, datë regjistrimi 16.07.2015 me objekt “Vjedhje të energjisë elektrike”, e kategorisë penale themeli, ka përfunduar me vendimin nr. 303, datë 29.06.2016, për një kohëzgjatje prej 11 muaj e 13 ditë, jashtë afatit standard minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjen në datë 04.05.2016, duke caktuar seancën e parë gjyqësore në datë 19.05.2016, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 1 muaj e 25 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muajsh*** parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (vi) Në çështjen civile me nr. 773/1501 regj, me palë paditëse N.S, me objekt të padisë «Marrëdhënie pune», rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 15.01.2013 dhe me shortin elektronik të datës 23.07.2013 i është caktuar gjyqtarit Astrit Kalaja. Nga aktet e dosjes (regjistri i njoftimeve) rezulton se ajo është vënë në lëvizje nga gjyqtari në datë 07.05.2014, duke planifikuar seancën e parë në datë 15.05.2014, dhe ka përfunduar në datë 15.05.2014. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar për 8 ditë nga data e nxjerrjes për gjyq, ***brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj*** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;
- (vii) Në çështjen civile me nr. 1543 regj, me objekt të padisë «Përmbyshje detyrimi kontraktual.. », rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 21.02.2014 dhe me shortin të datës 24.02.2014 i është caktuar gjyqtarit Astrit Kalaja. Nga aktet e dosjes nuk rezultojnë të dhëna për datën në të cilën dosja është vënë në lëvizje, por rezultojnë të dhëna vetëm për seancën e parë gjyqësore të planifikuar në datë 20.11.2014. Gjykimi ka përfunduar në datë 20.11.2014. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar brenda ditës nga data e seancës së parë gjyqësore, ***brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj*** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;
- (viii) Në çështjen civile me nr. 839/1580 regj, me objekt të padisë «Shlyerje detyrimi », rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 07.02.2013 dhe i është caktuar në cilësinë e relatorit gjyqtarit Astrit Kalaja. Nga aktet e dosjes nuk rezultojnë të dhëna për datën në të cilën dosja është vënë në lëvizje, por rezultojnë të dhëna vetëm për seancën e parë gjyqësore të planifikuar në datë 22.05.2014. Gjykimi ka përfunduar në të njëjtën datë. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar brenda ditës nga data e seancës së parë gjyqësore, ***brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj*** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;
- (ix) Në çështjen civile me nr. 384/777/1246 regj, me objekt të padisë «Marrëdhënie pune», rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 27.06.2011 dhe me shortin manual të datës 23.07.2013 i është caktuar gjyqtarit Astrit Kalaja. Nga aktet e dosjes nuk rezultojnë të dhëna për datën në të cilën dosja është vënë në lëvizje, por rezultojnë të dhëna vetëm për seancën e parë gjyqësore të planifikuar në datë 18.11.2013. Gjykimi ka përfunduar në datë 05.12.2013. Pra referuar të dhënave të

sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar për 17 ditë nga data e seancës së parë gjyqësore, **brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;

- (x) Në çështjen civile me nr. 526/2001 regj, me objekt të padisë «Marrëdhënie pune», rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 11.11.2014 dhe me shortin e datës 17.11.2014 i është caktuar gjyqtarit Astrit Kalaja. Nga aktet e dosjes nuk rezultojnë të dhëna për datën në të cilën dosja është vënë në lëvizje, por rezultojnë të dhëna vetëm për seancën e parë gjyqësore të planifikuar në datë 13.05.2015. Gjykimi ka përfunduar në të njëjtën datë. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar brenda ditës nga data e seancës së parë gjyqësore, **brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;
- (xi) Çështja penale me nr. 110/610 regj, datë regjistrimi 10.10.2014, e kategorisë penale themeli, ka përfunduar me vendimin nr. 135, datë 26.03.2015, për një kohëzgjatje prej 5 muaj e 16 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjen në datë 17.02.2015, duke caktuar seancën e parë gjyqësore në datë 26.03.2015, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 1 muaj e 9 ditë, **brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muajsh** parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;
- (xii) Në çështjen civile me nr. 918 regj, me objekt të padisë «Njohje vjetërsie në punë», rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 27.01.2016 dhe me procesverbalin e datës 01.02.2016 i ka kaluar direkt gjyqtarit Astrit Kalaja. Nga aktet e dosjes rezulton se pas kalimit të çështjes gjyqtarit Astrit Kalaja, më datë 15.02.2016, prej tij është paraqitur përpara Kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkodër, kërkesa për përshpejtim në shqyrtimin e kësaj çështje, në kushtet kur kjo çështje ishte regjistruar në datë 21.03.2013. Kjo kërkesë, është pranuar nga Kryetari i gjykatës, i cili me Vendimin “Për përshpejtimin e gjykimit të çështjes”, me nr. 391, datë 15.02.2016, ka vendosur përshpejtimin e gjykimit të kësaj çështje. Gjyqtari kryesues ka vendosur të caktojë seancën gjyqësore më datë 07.03.2016 dhe gjykimi ka përfunduar në të njëjtën datë. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar për një afat prej 20 ditë nga data që gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjen, **brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;
- (xiii) Çështja penale me nr. 812 regj, datë regjistrimi 26.03.2016, e kategorisë penale themeli, ka përfunduar me vendimin nr. 260, datë 13.06.2016, për një kohëzgjatje prej 2 muaj e 17 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjen në datë 10.05.2016, duke caktuar seancën e parë gjyqësore në datë 30.05.2016, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 1 muaj e 3 ditë, **brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muajsh** parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.

Referuar vendimit të administruar për shkak të ankesave, konstatohet se:

(xiv) Në çështjen civile nr. 841/1582 (00138) regj, me palë paditëse V.L. dhe L.L., palë e paditur F.B., E.B., etj., me objekt “Konstatimin si absolutisht të pavlefshmen të vendimit të KKP...”, sipas të dhënave në pjesën hyrëse të këtij vendimi rezulton se data e regjistrimit është 15.02.2013 dhe data e përfundimit të çështjes 16.10.2014, pra për një kohëzgjatje prej 1 vit e 8 muaj, në tejkallim të standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD. Në mungesë të të dhënave mbi datën e vënies në lëvizje të çështjes dhe caktimit të seancës së parë gjyqësore nëpërmjet shpalljes së listave të gjykimit nga kryetari i Gjykatës në referim të parashikimeve të nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile, përlllogaritja e kohëzgjatjes së gjykimit në këtë këndvështrim rezulton e pamundur dhe për pasojë, ky vendim nuk mund të shërbejë si burim vlerësimi për këtë tregues, pasi nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar kohëzgjatjen e gjykimit dhe për pasojë, për të vlerësuar nëse ajo është përfunduar brenda apo jashtë afatit standard në fuqi.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, sikundër rezultoi edhe më sipër, të gjitha çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, kanë përfunduar brenda afatit standard minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim ose data e seancës së parë gjyqësore në disa raste.

Nga burimet e vlerësimit, për disa nga çështjet e mësipërme, nuk ka informacion për datën e nxjerrjes për gjykim pasi në të gjitha dosjet nuk administrohet vendim për caktimin e seancës së parë gjyqësore apo njoftimet me shpallje publike, përveç çështjeve penale, ku si datë e tillë konsiderohet data e caktimit të seancës gjyqësore nga ana e gjyqtarit. Para ndryshimeve të K.Pr.Civile me ligjin 38/2017, nxjerrja e çështjeve civile për gjykim bëhej nga Kryetari i Gjykatës, i cili urdhëronte nxjerrjen e çështjeve për gjykim, nëpërmjet shpalljeve të afishuara në Gjykatën e Apelit dhe gjykatat respektive të rretheve gjyqësore, nëpërmjet afishimit të shpalljeve, 3 javë para datës së seancës gjyqësore (neni 460 i K.Pr.Civile para ndryshimeve). Në këtë situatë, edhe nëse do të llogarisim përfshirjen e këtij afati 3/javor, në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve si më lart, përsëri do të arrinim në të njëjtin konkluzion në lidhje me respektimin e standardit minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej saj tej standardit minimal, është 0 %.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk konkluzion lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e apelit në periudhën e vlerësimit. Po ashtu, për 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe për vendimin e administruar për shkak të ankesave, sikurse u analizua në treguesin më sipër, nga të dhënat që rezultojnë nga dosja e rivlerësimit, nuk mund të përllogaritet kohëzgjatja e gjykimit dhe për pasojë, rezulton e pamundur që këto 4 vendime të shërbejnë si burim për përllogaritjen e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.⁵¹Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (*10 çështjet e marra në analizë janë 6 çështje civile dhe 4 çështje penale themeli, krime*), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 4 (katër) çështjet në kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë rreth 42 ditë ose 1 muaj dhe 12 ditë, ***pra më e shkurtër se standardi minimal kohor*** për gjykimin e çështjeve penale të themelit ne Gjykatën e Apelit.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 6 (gjashtë) çështjet në kategorinë e çështjeve “civile themeli”, rezulton të jetë rreth 7.5 ditë, ***pra më e shkurtër se standardi minimal kohor*** prej 6 (gjashtë) muajsh për gjykimin e çështjeve civile të themelit ne Gjykatën e Apelit.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha çështjet e kësaj kategorie.

⁵¹ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “*Subjekti rivlerësimit Astrit Kalaja në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Shkodër, në fushën e të drejtës civile dhe penale. Ai ka deklaruar se në periudhën 2014, 2015 dhe 2016 i janë caktuar për gjykim gjithsej 1457 çështje, ka përfunduar si relator 984 çështje dhe ka mbartur në vitin e fundit të detyrës 139 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështje, bazuar në këto të dhëna, është 67.5%*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe vërtetimit nr. 133 Prot., datë 19.01.2017,⁵² të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton se gjyqtari Astrit Kalaja për të gjithë periudhën e vlerësimit 2013-2016, paraqet këtë ngarkesë çështjesh, të ndarë për çdo vit kalendarik:

- për vitin e plotë 2013 gjyqtarit i janë caktuar 520 çështje dhe ka përfunduar 268 çështje. *Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 51.5%.*
- për vitin e plotë 2014 gjyqtarit i janë caktuar 589 çështje dhe ka përfunduar 365 çështje. *Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 62%.*
- për vitin e plotë 2015 gjyqtarit i janë caktuar 418 çështje dhe ka përfunduar 308 çështje. *Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 73.7%.*
- për vitin e plotë 2016 gjyqtarit i janë caktuar 450 çështje dhe ka përfunduar 311 çështje. *Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 69%.*

⁵² faqe 14 e dosjes së rivlerësimit.

Pra, për të gjithë periudhën e vlerësimit rezulton se gjyqtarit i janë caktuar në total 1977 çështje dhe ka përfunduar 1252 çështje. Sipas këtyre të dhënave rendimentit, rezulton në **masën 63.3%**.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 63.3%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 2 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli”*. Bazuar në këtë parashikim, dhe në faktin se në Aneksin 1 “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” nuk është parashikuar standardi orientues sasior i çështjeve të gjyqtarit të apelit i cili gjykon si në dhomë civile dhe në dhomë penale, në të dyja rastet nëse i referohemi dy pikave të parashikuara në rregullore pika “h” dhe pika “i”, gjyqtar subjekt vlerësimi del me një përqindje me të madhe se 50% mbi standardin sasior të çështjeve të gjykuara brenda një viti kalendarik.

Referuar pikës “h” dhe pikës “i” të aneksit

- për vitin e plotë 2013 gjyqtarit ka përfunduar 268 çështje dhe 78.6% mbi standardin sasior të çështjeve të gjykuara brenda një viti kalendarik sipas pikës ‘h’ ose 35% sipas pikës “i” të aneksit.
- për vitin e plotë 2014 gjyqtarit ka përfunduar 365 çështje dhe 143% mbi standardin sasior të çështjeve të gjykuara brenda një viti kalendarik sipas pikës ‘h’ ose 82.5% sipas pikës “i” të aneksit.
- për vitin e plotë 2015 gjyqtari ka përfunduar 308 çështje 107.3% mbi standardin sasior të çështjeve të gjykuara brenda një viti kalendarik sipas pikës ‘h’ ose 54% sipas pikës “i” të aneksit.
- për vitin e plotë 2016 gjyqtari ka përfunduar 311 çështje. *Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 105.3% sipas pikës ‘h’ ose 55.5% sipas pikës “i” të aneksit.*

Gjithashtu duke konsideruar ngarkesën e përgjithshme në punë të gjyqtarit, angazhimin e tij në plotësimin e trupave gjykues në gjykatën e Apelit ku gjykimet zhvillohen me trup gjykues me 3 gjyqtarë, si dhe faktin se nxjerrja e çështjeve civile për gjykim në periudhën e vlerësimit, ka qenë atribut i Kryetarit të Gjykatës, vlerësoj se për këtë tregues niveli i pikëzimit që përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit duhet të rritet duke u pikëzuar përfundimisht me 10 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari pikëzohet me 10 pikë.*

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë

periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se gjyqtari Astrit Kalaja nuk i kushton rëndësi të veçantë arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 22 ditë nga shpallja (shih dosjet nr.2 dhe 5), për 24 ditë nga shpallja (shih dosjen nr.1), për 25 ditë nga shpallja (shih dosjen nr. 4) dhe për 35 ditë (nga shpallja (shih dosjen nr.3). Ndër 5 dosjet e vëzhguar, rezulton se të pesta janë arsyetuar jashtë afatit ligjor, vonesa nuk ka qenë e pakët por gjithsesi vetëm në një rast është tejkalkuar afati i rekursit prej 30 ditë. Së fundmi, duke konstatuar të dhënat e mësipërme, duhet evidentuar se gjyqtari Astrit Kalaja ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal, ai nuk ka respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve që i janë caktuar, si dhe ka arsyetuar me vonesë vendimet gjyqësore”*.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore, kjo kohë, gjithsesi, nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 30 (tridhjetë) ditor, sipas parashikimeve të nenit 435 pika 1 të K.Pr.Penale,⁵³ në fuqi para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e rekursit ndaj vendimit penal të gjykatës së apelit, kur palët ishin prezent, fillonte nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Mbështetur në të njëjtin arsyetim, edhe për vendimet civile, K.Pr.Civile (para nëntorit 2017) nuk parashikonte afat procedural, por gjithsesi, ky afat nuk mund të ishte më i gjatë se afati për ushtrimin e të drejtës së rekursit sipas parashikimeve të nenit 443 paragrafi i dytë dhe nenit 476

⁵³ Neni 35 pika 1 i K.Pr.Penale, para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, parashikonte se: “Rekursi duhet të paraqitet me shkrim brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë.”.

të K.Pr.Civile.⁵⁴ Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 30 ditor i rekursit ndaj vendimit penal dhe civil të gjykatës së apelit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- Dosja 1, që i përket vendimit penal me nr. 227, datë 08.05.2014, është dorëzuar në datën 02.06.2014 - (25 ditë), **brenda afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 2, që i përket vendimit penal me nr.303, datë 29.06.2016 është dorëzuar në datën 21.07.2016 - (22 ditë), **brenda afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 3, që i përket vendimit penal me nr. 208, datë 10.08.2015, është dorëzuar në datën 14.09.2015 - (35 ditë), **jashtë afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 4, që i përket vendimit civil me nr. 997, datë 15.05.2014, është dorëzuar në datën 09.06.2014 - (25 ditë), **brenda afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 5, që i përket vendimit civil me nr. 1389, datë 20.11.2014, është dorëzuar në datën 12.12.2014 - (22 ditë), **brenda afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Apelit Shkodër me shkresën nr. 1920/1 Prot., datë 22.09.2022, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 21.09.2022, rezulton se:

- Dosja 6, që i përket vendimit civil me nr. 1023, datë 22.05.2014, është dorëzuar në datën 06.06.2014 - (15 ditë), **brenda afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 7, që i përket vendimit civil me nr. 700, datë 05.12.2013, është dorëzuar në datën 24.12.2013 - (19 ditë), **brenda afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 8, që i përket vendimit civil me nr. 293, datë 13.05.2015, është dorëzuar në datën 01.06.2015 - (18 ditë), **brenda afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 9, që i përket vendimit penal me nr. 135, datë 26.03.2015, është dorëzuar në datën 15.04.2015 - (19 ditë), **brenda afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 10, që i përket vendimit civil me nr. 112, datë 07.03.2016, është dorëzuar në datën 31.03.2016 - (24 ditë), **brenda afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

⁵⁴ Neni 476 paragrafi i parë i K.Pr.Civile parashikon se: “*Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve*”. Në nenin 443 të K.Pr.Civile parashikohet se: “*Afati për të bërë recurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë*”.

- Dosja 11, që i përket vendimit penal me nr. 260, datë 13.06.2016, është dorëzuar në datën 27.06.2016 - (14 ditë), **brenda afatit 30 ditor** për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë *penale krime*, për 4 dosje është 20 ditë; për kategorinë *kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak*, për 1 dosje është 35 ditë; për kategorinë *civile themeli*, për 6 çështje, është 20.5 ditë.

Nga të dhënat e analizuara më sipër, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar, nga tre kategori çështjes, për 1 prej tyre rezulton e **tejkalar me vetëm 5 ditë**, në raport me afatin 30 ditor të rekursit, analizuar më sipër në këtë tregues. Gjithashtu, për këtë kategori, rezulton se vendimi është dhënë gjatë periudhës së muajit gusht (periudha në të cilën gjyqtarët marrin lejen vjetore), gjithashtu, **ky tejkallim është i papërfillshëm** dhe nuk ndikon në shkallën e aftësisë së gjyqtarit në drejtim të arsyetimit në kohë të vendimeve.

KONKLuzioni

Në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për arsyetimin e vendimeve në një kohë të shpejtë, e cila rezulton më pak se afatit 30/ditor të parashikuar për ushtrimin e së drejtës së rekursit, me përjashtim të kategorisë *kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak*, në të cilën përfshihet vetëm një dosje dhe tejkallimi i këtij afati është vetëm 5 ditor, i cili nuk ndikon shkallën e aftësisë së gjyqtarit në këtë drejtim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë.*

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE GJYQËSORE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit Astrit Kalaja ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. 3 prej dosjeve të vëzhguara kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjet nr.3, 4 dhe 5), një dosje me 2 seanca (shih dosjen nr.1) ndërsa dosja tjetër ka përfunduar me 4 seanca (shih dosjen nr.2). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 9 seanca të zhvilluara prej tij. 5 prej këtyre seancave kanë qenë produktive dhe 4 seanca kanë qenë joproduktive (shih dosjet nr.1 dhe 2). Në këto dy raste, seancat kanë dështuar për mosparaqitje të të pandehurit (shih dosjet nr.1 dhe 2), megjithëse palët ishin njoftuar me shpallje për zhvillimin e seancës rregullisht më shumë se 10 ditë përpara datës së seancës. Në rastin e gjykimit të zhvilluar me 4 seanca, seanca e dytë dhe e tretë gjyqësore janë caktuar duke respektuar afatin 15 ditor të parashikuar nga nenin 342/2 i K.Pr.Penale, por seanca e katërt është caktuar pas 16 ditëve nga seanca e tretë (shih dosjen nr.2). Nuk ka asnjë seancë të dështuar për shkak të njoftimeve të palëve, ndonëse duhet të dokumentojë më mirë kryerjen e veprimeve (shih të dhënat tek Aftësia për të Administruar Dosjet). Një tipar për tu përmirësuar është zhvillimi i seancave gjyqësore jo gjithnjë në sallë gjykimi, pasi nga 5 dosjet të vëzhguara, vetëm në një të një prej tyre seancat gjyqësore ishin të regjistruar në sistem audio. Kjo ka ardhur për shkakun objektiv të implementimit të këtij sistemi në Gjykatën e Apelit Shkodër, pas datës 01.04.2015. Nga ana tjetër, nga vëzhgimi i 5 dosjeve është konstatuar se të gjitha seancat kanë filluar me vonesë (shih dosjet nr.1, 2, 3, 4 dhe 5), ku në asnjë prej rasteve, nuk është relatuar vonesa dhe dokumentuar shkaku. Megjithatë, në të gjitha rastet vonesa nuk ka shkaktuar pasoja të dukshme”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, 10 prej tyre vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, duke përjashtuar kështu dosjen nr.3 të përzgjedhur gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, e cila i takon kategorisë *kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake*.

- Në katër çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

Në çështjet civile rezulton se:

- (i) Çështja me nr. regjistri 773/1501, datë regjistrimi 15.01.2013, përfunduar me vendimin nr. 997, datë 15.05.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka përfunduar me **1 seancë**;
- (ii) Çështja me nr. regjistri 1543, datë regjistrimi 21.02.2014, përfunduar me vendimin nr. 1389, datë 20.11.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka përfunduar me **1 seancë**.

Në çështjet penale rezulton se:

- (iii) Çështja me nr. regjistri 88/547, datë regjistrimi 19.07.2013, përfunduar me vendimin nr. 227, datë 08.05.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka përfunduar me **2 seanca**, ku seanca e parë gjyqësore është shtyrë me qëllim njoftimin e rregullt të të pandehurit, në kushtet kur nuk konfirmohet marrja e dëgjimit të tij;

(iv) Çështja me nr. regjistri 227/674, datë regjistrimi 16.07.2015, përfunduar me vendimin nr. 303, datë 29.06.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka përfunduar me **4 seanca**, ku 3 seanca gjyqësore janë shtyrë me qëllim njoftimin e të pandehurit.

➤ Në gjashtë çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

Në çështjet civile rezulton se:

- (v) Çështja me nr. regjistri 839/1580, datë regjistrimi 07.02.2013, përfunduar me vendimin nr. 1023, datë 22.05.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka përfunduar me **1 seancë**;
- (vi) Çështja me nr. regjistri 384/777/1246, datë regjistrimi 27.06.2011, përfunduar me vendimin nr. 700, datë 05.12.2013 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka përfunduar me **2 seanca** ku seanca e parë gjyqësore është shtyrë me kërkesë të palës së paditur e cila për arsye objektive nuk ka qenë prezent në gjykim.
- (vii) Çështja me nr. regjistri 526/2001, datë regjistrimi 11.11.2014, përfunduar me vendimin nr. 293, datë 13.05.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka përfunduar me **1 seancë**.
- (viii) Çështja me nr. regjistri 918, datë regjistrimi 27.01.2016, përfunduar me vendimin nr. 112, datë 07.03.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka përfunduar me **1 seancë**.

Në çështjet penale rezulton se:

- (ix) Çështja me nr. regjistri 110/610, datë regjistrimi 10.10.2014, përfunduar me vendimin nr. 135, datë 26.03.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka përfunduar me **1 seancë**.
- (x) Çështja me nr. regjistri 812, datë regjistrimi 26.03.2016, përfunduar me vendimin nr. 260, datë 13.06.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka përfunduar me **2 seanca**, ku seanca e parë gjyqësore është shtyrë për ti dhënë mundësi mbrojtësit të të pandehurit për tu njohur me aktet e dosjes, me qëllim garantimin e një mbrojtje efektive të tij.

Numri mesatar i seancave gjyqësore në çështjet e vëzhguara është **1.6 seanca**. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra kohore dhe përgjithësisht çështjet kanë përfunduar me 1 ose 2 seanca⁵⁵. Seancat përgjithësisht janë regjistruar në sistem audio, duke konsideruar momentin e fillimit të funksionimit të këtij sistemi në Gjykatën e Apelit Shkodër pas datës 01.04.2015.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (*penale themeli dhe civile themeli*) varion nga 1 deri në 4 seanca gjyqësore. **Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 10 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 1.6 seanca.**

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile dhe penale themeli me palë) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (*neni 460 të K.Pr.Civile dhe neni 426 dhe 342/2 të K.Pr.Penale*). Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si *njoftimit i palëve për të marrë pjesë në seancë, apo dhënia kohë për tu njohur me aktet e dosjes etj.*

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu

⁵⁵ Me përjashtim të dosjes nr.2, që i përket vendimit nr. 303, datë 29.06.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër, në të cilën janë zhvilluar 4 seanca gjyqësore.

referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtarë është 1.6 seanca dhe gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuara është më i vogël se 3 si dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave jo produktive është e lartë, ai duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Ai është i qartë për rolin e Gjykatës së Apelit dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura në apelin e palëve. Ndër 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar vetëm një rast, kur gjykata ka vendosur riçeljen pjesërisht të hetimit gjyqësor (shih dosjen nr.5). Po ashtu, në këtë aspekt duhet evidentuar se ndër 5 dosjet e vëzhguara, vetëm në një rast është kthyer çështja për rigjykim në shkallë të parë (shih dosjen nr.5). Së fundmi, në këtë aspekt duhet evidentuar se prej 5 vendimeve të 5 dosjeve të vëzhguara janë ankimuar dy vendime (shih dosjet nr. 1 dhe 2), por vendimi që i përket dosjes nr.2 akoma nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, ndërsa vendimi që i përket dosjes nr.1, nuk është cenuar nga Gjykata e Lartë - pra nuk janë evidentuar gabime gjyqësore të kryera prej tij nga kontrolli gjyqësor i brendshëm”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Në çështjet penale, dokumentohet kryerja e veprimeve paraprake të gjyqimit në përputhje me nenin 426 të K.Pr.Penale, ku edhe pse vënia në lëvizje dhe nxjerrja e çështjes për gjykim nuk është bërë nëpërmjet një akti formal (urdhër, vendim), nga gjyqtari në cilësinë e relatorit, është bërë njoftimi i palëve për zhvillimin e seancës së parë gjyqësore. Ndërsa në çështjet civile, nuk evidentohen veprimet paraprake të kryera në gjyqtari me qëllim nxjerrjen e çështjes për gjykim e datën e caktimit të seancës gjyqësore. Kjo sepse neni 460 i K.Pr.Civile para ndryshimeve me Ligjin 38/2017 parashikonte : “....2. Kryetari i gjykatës së apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjyqimit. 3. Sekretaria e gjykatës së apelit i njofton palët rregullisht (nenet 128-133) të paktën 10 ditë më parë, ditën e shqyrtimit të çështjes në apel, si dhe shpall listën përkatëse të çështjeve”.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Seancat gjyqësore përgjithësisht nuk janë mbajtur audio, kjo për shkak se vënia në funksion i sistemit audio në Gjykatën e Apelit Shkodër është bërë pas datës 01.04.2015.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi. Gjatë zhvillimit të gjyqimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për kryerjen e veprimeve lidhur me verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjyqimit, zhvillimin e gjyqimit në mungesë, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*si shkallë e dytë*), dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje te vëzhguara, seancat gjyqësore të planifikuara përgjithësisht janë çelur në kohë, por në disa raste të tjera, janë konstatuar vonesa në fillimin e tyre si dhe nuk është relatuar shkak i fillimit me vonesë por, këto vonesa nuk kanë ndikuar në ecurinë e gjyqimit apo në dështimin e seancës.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale,

duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil në Gjykatën e Apelit, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar se aktet themelore nuk janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë, por në dosjen nr.1, procesverbali gjyqësor i datës 08.05.2014 nuk është i nënshkruar nga sekretarja gjyqësore, konform kërkesave të nenit 345/2 të Kodit të Procedurës Penale, por vetëm nga kryesuesi dhe anëtarët e trupit gjykues.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e dosjeve përgjithësisht janë renditur në mënyrë të rregullt. Në disa prej tyre renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik (sipas kategorive të akteve) dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Kryesisht aktet renditen në mënyrë logjike, sipas kategorisë (kërkesat me shkrim të palëve, njoftimet dhe fletëthirrjet e kryera gjatë gjykimit, konkluzionet përfundimtare, procesverbali i seancës gjyqësore dhe vendimi gjyqësor përfundimtar) dhe në rend kronologjik (sipas datave ose momentit të paraqitjes së tyre) brenda së njëjtës kategori aktesh. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit.

KONKLUZIONI

Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...në dosjen nr.4 gjendet e administruar lista e gjykimeve e gjyqtarës Fjoralba Prifti dhe jo e subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja. Gjithashtu, tek 5 dosjet janë konstatuar edhe disa mangësi, që janë të njëjta, që tregon se bëhet fjalë edhe për metodologji pune. Kështu, në të 5 dosjet gjyqësore nuk ka akte që të dokumentojnë caktimin e seancës së parë gjyqësore; relatimin e gjyqtarit bëhet verbal dhe përmbledhet me një frazë të përgjithshme në procesverbal; nuk dokumentohet shkak i vonësës së seancës gjyqësore; vendimet e ndërmjetëm shënohen, por nuk tregojnë gjithmonë shkakun ligjor”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, vendimet gjyqësore).

Në dosjet e vëzhguara, konstatohet mungesa e vendimit të nxjerrjes së çështjes në seancë gjyqësore, por, në çështjet civile, sipas legjislacionit procedural në fuqi, caktimi i seancave bëhet nga kryetari i gjykatës dhe nuk ka qenë detyrim i gjyqtarit relator (neni 460 të K.Pr.Civile⁵⁶).

⁵⁶ Neni 460 i K.Pr.Civile para ndryshimeve me ligjin 38/2017 parashikonte : “...2. Kryetari i gjykatës së apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimit. 3. Sekretaria e gjykatës së apelit i njofton palët rregullisht (nenet 128-133) të paktën 10 ditë më parë, ditën e shqyrtimit të çështjes në apel, si dhe shpall listën përkatëse të çështjeve”

Ndërsa, në çështjet penale, neni 426, pika 1⁵⁷ i K.Pr.P parashikon si kompetencë të gjyqtarit kryesues urdhërimin për thirrjen e palëve, por nuk përcakton mënyrën e dokumentimit të këtij urdhërimi nëpërmjet një akti formal (urdhër, vendim) apo nëpërmjet njoftimeve. Mungesa e aktit formal në dosje, nuk ka sjellë pasoja në zhvillimin e gjykimit, pasi urdhërimi për thirrjen e palëve në seancën e parë gjyqësore, është dokumentuar dhe realizuar nëpërmjet akteve të njoftimit. Gjithashtu është konstatuar se në dosjen nr.4, gjendet e administruar lista e gjykimeve të gjyqtarës Fjoralba Prifti dhe mungon lista e gjykimeve për atë datë e gjyqtarit Astrit Kalaja, çka do të thotë se nuk i përket çështjes konkrete. Pavarësisht se kemi të bëjmë me një rast i cili nuk ka ndikuar në veprimet procedurale të kryera në atë dosje, kanë qenë të rregullta, në funksion të njoftimit të palëve duke mos sjellë parregullsi në njoftimin e tyre, nga ana e gjyqtarit duhet treguar një kujdes i shtuar sa i përket këtij fakti . Pasi edhe pse disa nga veprimet administrative në lidhje me dosjen janë të administratës, ligji ka parashikuar vlerësimin e gjyqtarit sa i përket këtij treguesi duke i dhenë dhe pikëzimin përkatës sipas rastit duke parashikuar aftësinë e tij nga niveli “dobët” deri tek aftësi “shumë e lartë” me pikëzimin maksimal.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, dhe Metodologjisë së Pikëzimit, në lidhje me *“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes. Treguesi i saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit vlerësohet dhe pikëzohet duke mbajtur parasysh aftësinë e gjyqtarit për të garantuar që dosja mos të ketë mungesa aktesh dhe që dokumentacioni i përfshirë në dosje të jetë i duhuri dhe t’i përkasë çështjes konkrete, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie mbi mesataren për këtë tregues.*

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 8 pikë.

Niveli i vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

⁵⁷Neni 426, pika 1 i K.Pr.Penale, para ndryshimeve me ligjin nr. 37/2017, parashikonte: “ 1. Kryetari i kolegjit të gjykatës së apelit urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre. Afati i paraqitjes nuk mund të jetë më i vogël se dhjetë ditë.”

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Astrit Kalaja. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt. Është e vërtet që janë konstatuar 9 seanca gjyqësore të filluara me vonesë, por kjo e dhënë është vlerësuar tek Aftësitë Organizative të Gjyqtarit, pasi nuk rezulton të jetë e lidhur me shkelje të disiplinës në punë”.*

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin Astrit Kalaja, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD, trajtuar gjerësisht në pjesën e parë të këtij projektraporti, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 224, datë 20.12.2019 , rezulton se për subjektin e rivlerësimit Astrit Kalaja janë paraqitur 14 (katërbëdhjetë) denoncime, nga të cilat, vetëm për 1 (një) prej tyre i është kërkuar shpjegim subjektit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet e paraqitura nga publiku dhe ka studiuar dosjet gjyqësore të administruara, ka konstatuar se nuk kanë rezultuar elemente konkrete që mund të vinin në pah ndonjë shkelje të rëndë procedurale, apo mungesa të theksuara në arsyetimet e vendimeve gjyqësore përkatëse nga subjektit i rivlerësimit, të cilat mund të

evidentonin mangësi të rënda profesionale. Ndërsa pas vënien në dijeni nga media dhe administrimit të dhënave lidhur me disa rrethana dhe dinamika ngjarjesh të publikuara nga një program televiziv investigativ, në datën 11.9.2019, ora 20:45, lidhur me procedimin penal 1201 dhe me nr. 28325 Akti K.P.K, ka konkluduar për transferimin e dosjes për inspektim ILD për shkaqe që mund të përbejnë shkelje disiplinore. Sa i përket vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit me nr. 1, datë 27.01.2022, nuk rezultojnë të jenë verifikuar apo trajtuar çështje që mund të ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit, posaçërisht në drejtim të etikës së tij në punë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1518/7 Prot datë 12.09.2023, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësore me nr. 4742 date 14.09.2023, pas shqyrtimit fillestar të rastit te referuar, ka konkluduar se sa referuar nga ana e KPK-së, nuk përmban fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinore, për këtë arsye është vendosur arkivimi i rastit pas verifikimit, bazuar ne nenin 122 pika 4 Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve ne RSH” i ndryshuar. Pavarësisht përfundimit të arritur nga ILD për arkivimin e rastit, theksojmë se kjo e dhënë nuk mund të shërbejë si burim vlerësimi për aq kohë sa kemi të bëjmë me një çështje të regjistruar në vitin 2018 dhe nuk i përket periudhës se vlerësimi 2013-2016.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimi për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Astrit Kalaja dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin Astrit Kalaja, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit 2013- 2016, për gjyqtarin 7 ankesa, në Inspektoratin e KLD, të cilat janë trajtuar, dhe arkivuar, sipas argumenteve të analizuara më sipër në këtë projektraport. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin nr. 224, datë 20.12.2019 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 1, datë 27.01.2022 në lidhje me etikën, kriterin e vlerësimit të figurës dhe pasurisë, ka konkluduar si vijon: *“...Në këtë analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, deri në deklaratën “Vetting”, nga ku, pasi janë konsideruar si të disponueshme shumat e përdorura për blerjen e pasurive nr. 1 dhe 2 – siç është arsyetuar në paragrafët përkatës – ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mangësi financiare të papërfillshëm, dhe për rrjedhojë analiza financiare përfundimtare (e riparë pas shpjegimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit), në rastin konkret, nuk paraqet shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së parashikuar në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016..... Për sa më sipër, Komisioni – pas hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016, dhe bazuar në provat dhe dokumentet e administruara, si dhe mbi dokumentet dhe informacionet e klasifikuara, të verifikuara nga trupi gjykues pranë organeve ligjzbatuese – në vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se në raportin e dërguar nga DSIK-ja vlerësimi i kryer nuk përmban rrethana bindëse, të mjaftueshme për të konkluduar për ndonjë favorizim apo ndikim të paligjshëm, nëpërmjet funksionit të tij, apo për konstatimin e ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme me ndonjë person të përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu, informacionet dhe dyshimet e ngritura mbi veprime korruptive (të përsëritura), nuk rezultojnë të provuara/bazuara, për të konkluduar bindshëm mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në to. 8. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, indiciet dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, konstatimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit – sipas pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016...”*

Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në vendimi nr.1, datë 27.01.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, konkluzohet se: *“69. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se konkluzionet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me kriterin e pasurisë janë të drejta dhe të bazuara në fakte dhe në ligj. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit Astrit Kalaja çmohet se ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. 70. Për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. 71. Për rrjedhojë, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi”.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja. Për vetë gjyqtarin Astrit Kalaja, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Por në raste të rralla, është konstatuar që subjekti i rivlerësimit Astrit Kalaja nuk ka respektuar rregullat procedurale”.*

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me palët në proces ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Për vetë gjyqtarin Astrit Kalaja, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (*11 dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari dhe 1 vendim të administruar për shkak të ankesave*) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar te palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet si *“I pa konsiderueshëm”*.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet si *i pa konsiderueshëm*.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “I pa konsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte tek 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”*.

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në këtë aspekt duhet evidentuar se nuk ka patur asnjë seancë gjyqësore të dështuar nga planifikimi, por ka patur vonesa në arsyetimin e

vendimeve gjyqësore, gje që tregon mungesën e produktivitetit të punës së tij, por edhe mungesë bashkëveprimi me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore (shih të dhënat tek Aftësitë Organizative)”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe në mungesë të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë .

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T'U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së dytë që kryen. Ai i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 13 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, me temë: “Falimentimi”, më 16 tetor 2013; “Ligji për shoqëritë tregtare”, më 02-03 dhjetor 2013; “KEDNJ dhe karta e BE-së për të drejtat themelore”, më 29-30 janar 2014; “Veprat penale që lidhen me korrupsionin”, më 23-24 qershor 2014; “Etika profesionale”, më 3 mars 2015; “të drejtat e njeriut”, më 30-31 mars 2015; “Efektet e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese për vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme”, më 01-02 dhjetor 2015; “Instituti juridik res iudicata, kuptimi material dhe procedural, dimensionet kushtetuese, konventore dhe ligjore”, më 15 dhjetor 2015; “Roli i sistemit të drejtësisë në mbrojtjen dhe promovimin e standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor. Roli i Shkollës së Magjistraturës përmes programit të trajnimit vazhdues, vlerësimi i nevojave për këto aspekte”, më 21 dhjetor 2015; “Roli i gjyqtarit kombëtar dhe zbatimin e legjisllacionit të BE-së”, më 10-11 shkurt 2016; “Gjykimi në mungesë në procesin civil”, më datë 18-19 prill 2016; “Standardet dhe praktikat e mira për strukturën dhe argumentimin e vendimeve gjyqësore”, më 16 maj 2016; “Nënshkrimi elektronik. Garancitë e përdorimit të dokumentit elektronik dhe ligji mbi nënshkrimin elektronik”, më 7 qershor 2016. Këto të dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 13 seminare dhe 20 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjecare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së dytë”.*

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.2915/3 Prot., datë 19.03.2019, vërtetimit me nr. 596 Prot., datë 20.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit.

Konkretisht, rezulton se gjyqtari Astrit Kalaja është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrësit në 13 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 20 ditë trajnimi.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 13 aktivitete të zhvilluara për 20 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e tij në veprimtari trajnuese si ekspert ose lehtësues në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin Astrit Kalaja, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij gjatë periudhës së vlerësimit, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lektor dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013–2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj. Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin Astrit Kalaja, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me këtë kriter.

Në dosjen e rivlerësimit, gjyqtari i ka bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit kopje të mikrotezës me temë “*Falimentimi si e drejtë komplekse, vështrimi analitik i elementeve thelbësor të saj*”,⁵⁸ të kryer në kuadër të përfundimit të studimeve “master” pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, tetot 2011, si dhe punimi “*Aspektet juridikë të mbarimit të martesës (pëlqimi reciprok i bashkëshortëve)*”, qershor 2004. Këto punime i përkasin viteve 2004 dhe 2011 dhe për pasojë nuk mund të shërbejë si burim vlerësimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Gjithashtu, nga aktet e dorëzuara nga gjyqtari, bashkëlidhur formularit, është dorëzuar edhe materiali “*Fitimi i pronësisë me testament (Vështrimi teorik dhe praktik e i disa aspekteve të këtij instituti)*”, por në këtë material të dorëzuar përveçse nuk evidentohet periudha hartimit të tij, gjithashtu nuk evidentohet se ku është publikuar, për pasojë nuk mund të shërbejë si burim vlerësimi.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se, për gjyqtarin Astrit Kalaja, ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duket të vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

⁵⁸ Faqe 38-41 e dosjes së rivlerësimit.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Nivelin e vlerësimit AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	389	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR